



MATJA E PANDEMISË HIJE:

**DHUNA NDAJ
GRAVE GJATË
COVID-19**

RAPORTI PËR SHQIPËRINË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Më shumë se gjysma e grave në Shqipëri kanë përjetuar ose njohin një grua tjetër që ka përjetuar DhNG (dhunë ndaj grave), dhe shprehen se e perceptojnë dhunën, abuzimin dhe ngacmimin e grave si një problem në komunitetet e tyre. Pandemia e COVID-19 u shoqërua me një rritje të dukshme të favorizuesve të DhNG-së dhe përkeqësoi tensionet ekzistuese si dhe problematikat e sigurisë për shumë gra. Këto problematika ndryshojnë si në lloj ashtu dhe seriozitet në varësi të statusit socio-ekonomik dhe cënueshmërisë ndaj faktorëve stresues. Ky studim thellohet në marrëdhëniet ndërmjet masave të DhNG dhe faktorëve demografik,

socio-ekonomik dhe të sjelljeve lidhur me to.

Edhe pse shumica e grave në Shqipëri mendojnë se siguria e tyre nuk është ndikuar ndjeshëm nga pandemia e COVID-19, studimi tregon se pandemia ka përkeqësuar shqetësimet për sigurinë e grave më të cënueshme, të cilat përballeshin me vështirësi edhe përpara pandemisë. Për më tepër, studimi vë në pah se elemente favorizuese të DhNG-së, të tillë si pasiguria ushqimore, humbja e të ardhurave dhe papunësia kanë rritur shqetësimet dhe përvojat e pasigurisë, si edhe kanë ndikuar te mirëqenia e përgjithshme e grave.

1. HYRJJE

Në vitin 2018, Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave, i kryer nga Instituti Shqiptar i Statistikave, në partneritet me UNDP-në dhe UN Women, zbuloi se 21% e grave në Shqipëri kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i tyre aktual ose i fundit dhe 8,2% po e përjetonin atë aktualisht.¹

Që nga fillimi i pandemisë, vlerësimet e shpejta të kryera nga UN Women duke përdorur të dhëna administrative nga policia, linjat e këshillimit për DhNG dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve vënë në dukje se pandemia e COVID-19 ka rritur faktorët e rrezikut për gratë, ka thelluar disa nga format ekzistuese të DhNG-së dhe ka penguar aksesin në shërbime që duhet të jenë në dispozicion të grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës.² Masat e zbatuara për të ndaluar përhapjen e pandemisë, si mbyll-

jet dhe vendosja e kufizimit të lëvizjeve, kanë pasur ndikim në faktorët e rrezikut të DhNG-së, veçanërisht për gratë dhe vajzat që u përballën me forma të shumëfishta diskriminimi. Gjatë periudhës së mbylljes në Shqipëri (nga muaji mars deri në maj 2020), numri i thirrjeve në linjën kombëtare të këshillimit u trefishua në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, ndërsa numri i raportimeve të dhunës në familje në polici ishte më i ulët se në vitin 2019.³

Përballë rrezikut që masat kufizuese kundër pandemisë COVID-19 i shkaktuan grave të cilat po përballeshin me dhunë në familje, qeveria shqiptare, dhe veçanërisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), zbatuan një sërë masash për t'iu përgjigjur këtij rreziku.⁴

1 INSTAT, UN Women dhe UNDP. 2018. Vrojt看 kombëtar me bazë popullatën 2018: [Dhuna ndaj grave dhe Vajzave në Shqipëri](#)

2 UN Women. 2020. "[COVID-19 dhe eliminimi i dhunës ndaj grave e vajzave.](#)"

3 UN Women Shqipëri. 2020. "Çfarë ndodhi pas COVID-19: Shqipëria."

4 Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). 2020. "[Praktikat e mira parandaluese dhe sfidat e hasura nga Shqipëria për të siguruar ushtrimin e efektshëm të të drejtave të njeriut gjatë pandemisë së Covid-19.](#)"

Qeveria urdhëroi vijimin në gjykatë të çështjeve familjare, duke përfshirë ato që lidheshin me dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve gjatë periudhës së masave anti-COVID-19. Kodi Penal gjithashtu forcoi dënimet për dhunën në familje. Gratë me urdhër mbrojtje u përfshinë bashkë me gratë kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike si një prej grupeve të para që përfituan nga paketa e masave ekonomike të ndërmarra nga qeveria. Përgjatë vitit të kaluar, qeveria gjithashtu miratoi një sërë protokollësh për të mundësuar vijimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbi jetuarat e DhNG dhe trafikimit, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve bazë duke u kujdesur të mos rrezikohet shëndeti i tyre dhe i ofruesve të shërbimeve, duke ndihmuar edhe autoritetet vendore për të adresuar në mënyrën e duhur rastet e dhunës në familje përgjatë periudhës së pandemisë.⁵ Qeveria gjithashtu inkurajoi qytetarët të raportojnë abuzimin në familje, duke theksuar rëndësinë e kësaj, veçanërisht gjatë periudhës së izolimit.

Në këtë kontekst, UN Women kontrakttoi Ipsos me qëllim kryerjen e një anketimi të shpejtë mbi ndikimin e COVID-19 në mirëqenien dhe sigurinë e grave në 13 vende nga rajone të ndryshme

të botës. Gjatë përshtatjes së metodologjisë së studimit në mënyrë që të ishte e zbatueshme në kontekstin e pandemisë së COVID-19, u përdorën metoda të përafërta mbi përvojën e DhNG-së, me qëllim mbledhjen e të dhënave për tema të ndjeshme duke reduktuar ndërkohë rrezikun për të anketuarat. Për rrjedhojë, të dhënat mund të mos jenë drejtpërdrejt të krahasueshme me studimet të tjera të kryera përpara pandemisë.


Sigurimi i të dhënave të besueshme, të mbledhura në përputhje me standardet etike, metodologjike, dhe të sigurisë, pa i vënë gratë në ankth dhe rrezik më të shtuar të dhunës, ishte kritik për të treguar se si politikat dhe programet mund t'u përgjigjen përpjekjeve gjithëpërfshirëse të OKB-së, me qëllim zgjerimin e veprimeve për adresimin e DhNG-së në kontekstin e pandemisë së COVID-19.

Ky raport detajon gjetjet e anketimit të kryer në Shqipëri gjatë muajve gusht-shtator 2021. Në anketim u përfshinë gra të moshës 18 vjeç e sipër të cilat kishin akses në një telefon celular. Pronësia e telefonave celularë për gratë e moshës 18-49 vjeç, për vitin 2018 në Shqipëri përllogaritet të jetë 94%.⁶


5 Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP). 2020. [Protokoll për manaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes mekanizmit të koordinuar të referimit \(CRM\) gjatë situatës së COVID-19.](#)

6 INSTAT dhe UN Women. 2021. [Gratë dhe Burrat në Shqipëri: 2021.](#)


GJETJET KRYESORE



abuzim verbal



mohim i nevojave bazë



ngacmim seksual



6%

e grave u ndjenë të pasigurta në shtëpitë e tyre.



16%

e grave u shprehën se pasiguria është shtuar si rezultat i COVID-19.



11%

e grave jetojnë në shtëpi ku ka konflikte të paktën një herë në javë midis të rriturve.



23%

u shprehen se konflikti midis të rriturve është bërë më i shpeshtë si pasojë e pandemisë së COVID-19.



51%

e grave mendojnë se përjetimi i dhunës verbale apo fizike nga partneri është i zakonshëm tek gratë në komunitetin ku jetojnë.



79%

u shprehen se situata është perkeqësuar si pasojë e pandemisë së COVID-19.



52%

e grave mendojnë se lëndimi fizik, abuzimi dhe ngacmimi janë një problem për gratë në komunitetin e tyre.



29%

e grave mendojnë se lëndimi fizik, abuzimi dhe ngacmimi janë shtuar që prej fillimit të pandemisë së COVID-19.



34%

e grave ndjehen të pasigurta për të ecur vetëm gjatë natës.



13%

e grave ndjehen të pasigurta për të ecur vetëm gjatë ditës.



39%

e grave mendojnë se është e zakonshme që gratë të ngacmohen në mjedise publike.



1. PERCEPTIMET RRETH DHUNËS NDAJ GRAVE

2.1 Përlogaritjet e përafërta të dhunës ndaj grave në komunitet

Kur merret parasysh matja e dhunës ndaj grave në nivel komuniteti në këtë studim, është e rëndësishme të dihen metodat e përdorura. Për shkak të realizimit në distancë të këtij anketimi, pyetjet e tërthorta shërbyen si tregues të përafërt të DhNG-së, prandaj, nuk ishte e mundur që të bëhej dallimi mes përvojave të të anketuarave nga ato të grave të tjera në komunitetin e tyre, ose nëse kjo përvojë kishte ndodhur brenda apo jashtë familjes. Ndaj, edhe pse të dhënat nga ky studim nuk duhet të interpre-


tohen si të dhëna mbi nivelin e përhapjes së DhNG, ato ofrojnë informacion kritik mbi ndikimin e pandemisë së COVID-19 në perceptimin e grave në lidhje me mirëqenien dhe sigurinë e tyre.

Më shumë se gjysma e grave në Shqipëri (53%) njohin një grua që ka përjetuar, ose kanë përjetuar vetë një formë të DhNG-së gjatë jetës së tyre (si dhuna, mohimi i nevojave bazë, ngacmimi seksual, kufizimet ose abuzimi verbal).⁷ Nga këto, 17% filluan të përjetojnë DhNG ose ishin vënë në dijeni të një gruaje që kishte përjetuar DhNG që prej fillimit të pandemisë së COVID-19.

7 Testimi i kësaj pyetje tregoi se për shumë gra izolimi i detyrueshëm dhe mohimi i nevojave bazike u influencuan nga masat kundër COVID-19 dhe vështirësitë ekonomike. Gjetjet e këtij studimi hamendësojnë se gratë me shumë gjasa mbajnë peshën kryesore të impaktit të pandemisë; megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh konteksti i përgjithshëm kur interpretojmë rezultatet.

FIGURA 1

Përjetimi ose njohja e formave specifike të DhNG, që nga fillimi i pandemisë COVID-19 dhe përgjatë jetës



Gratë e reja të moshës 18-29 vjeç dhe ato që u identifikuan si beqare, kishin më shumë gjasa të kishin përjetuar ose njihnin dikë që ka përjetuar një formë të DhNG-së gjatë jetës së tyre (përkatësisht 60% dhe 62%), krahasuar me gratë mesatarisht. Në veçanti, gratë më të reja kishin më shumë gjasa të raportonin përvoja (personale apo të të afërmëve) të abuzimit verbal dhe ngacmimit seksual, qoftë gjatë jetës së tyre (24% për të dyja) ose vetëm nga fillimi i pandemisë së COVID-19 (12% e grave të moshës 18-29 vjeç dhe 14% e grave beqare).

Rezultatet nga Shqipëria tregojnë një lidhje të fortë ndërmjet të ardhurave dhe punësimit me përjetimin e DhNG-së. Gratë që u shprehën se pësuan një rënie të të ardhurave vitin e fundit kishin më shumë gjasa se mesatarja e grave të ishin ekspozuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndaj pothuajse të gjitha formave të DhNG-së, qoftë ekskluzivisht që prej fillimit të pandemisë së COVID-19 ose gjatë jetës së tyre. Kjo ishte veçanërisht e theksuar në kategorinë e abuzimit verbal (34% gjatë jetës së tyre, 13% ekskluzivisht që nga fillimi i pandemisë së COVID-19) dhe mohimit të nevojave bazë (27% gjatë jetës së tyre, 13% ekskluzivisht që nga fillimi i pandemisë së COVID-19). Për gratë e papunësuar, përjetimi i abuzimit verbal që me fillimin e pandemisë së COVID-19 ishte tre herë më i lartë në krahasim me popullatën e anketuar (31% krahasuar me 11%), ndërsa përjetimi i dhunës fizike ishte dy herë më i lartë në krahasim me kampionin e anketuar (12% krahasuar me 5%). Për më

tepër, gratë që u shprehën se kontribuojnë më shumë në të ardhurat e familjes sesa partneri i tyre kishin më tepër gjasa të kishin përjetuar ngacmime seksuale gjatë jetës së tyre (35% krahasuar me 24% mesatarisht).

Gratë që ndiheshin të pasigurta në shtëpitë e tyre dhe ato që ndiheshin të pasigurta duke ecur vetëm në rrugë gjatë ditës apo natës, kishin shumë më tepër gjasa të raportonin se kishin përjetuar ose njihnin një grua që ka përjetuar një formë të DhNG-së gjatë jetës së tyre. Gratë që u shprehën se janë ndjerë të pasigurta në shtëpitë e tyre kishin edhe më shumë gjasa të shpreheshin se kishin përjetuar abuzim verbal ose mohim të nevojave bazë me fillimin e pandemisë së COVID-19, çka tregon se disa gra përjetojnë forma të ndërthurura të dhunës.

Për më tepër, gratë që u shprehën se ato vetë apo dikush që ato njihnin kishte përjetuar të paktën një formë të DhNG-së, kishin gjithashtu më shumë gjasa të kishin pasiguri të theksuar ushqimore. Në veçanti, gratë që u shprehën se ato vetë apo një grua tjetër që ato njohin ka përjetuar mohim të nevojave bazë, kishin katër herë më shumë gjasa të kishin pasiguri ushqimore krahasuar me ato që nuk kishin përjetuar diçka të tillë, dhe pothuajse dy herë më shumë gjasa të ndanin përvoja të izolimit të detyruar. Gratë që u shprehën se ato vetë apo një grua tjetër që ato njohin ka përjetuar abuzim verbal ose ngacmim seksual, në përgjithësi kishin dy herë më shumë gjasa të kishin pasiguri ushqimore.

3. NDJESITË E SIGURISË


3.1 Siguria personale brenda shtëpisë

Kur bëhet fjalë për sigurinë brenda familjes, 11% e grave të anketuara u shprehën se ka pasur konflikt mes të rriturve në familjen e tyre të paktën çdo javë në gjashtë muajt e fundit; 45% u shprehën se konflikti ka ndodhur një herë në muaj ose më pak; dhe 42% u shprehën se nuk kanë pasur asnjë konflikt. Gratë që jetojnë me fëmijë kishin më shumë gjasa se ato që jetojnë pa fëmijë të shprehen se kishin pasur konflikte familjare të paktën çdo javë (14% krahasuar me 9%).

Ndërsa shumica e grave (65%) u shprehën

se pandemia e COVID-19 nuk ka ndikuar në shpeshtësinë e debateve brenda familjeve të tyre, pothuajse një e katërta (23%) u shprehën se konflikti është bërë më i shpeshtë që nga fillimi i pandemisë. Mes grave që u shprehën se të ardhurat e tyre ishin ulur, 28% u shprehën se konflikti në familje ishte shtuar si rezultat i pandemisë së COVID-19. Në të njëjtën mënyrë u shprehën edhe gratë që fitojnë më shumë se partneri i tyre (33%), duke sugjeruar kështu se ndikimet pasuese të COVID-19 lidhen me tensionet familjare. Për më tepër, gratë që përjetuan më shpesh konflikt kishin tre herë më shumë gjasa të shpreheshin se shpeshtësia e konflikteve është rritur si rezultat i pandemisë, duke sugjeruar se tensionet ekzistuese në

FIGURA 2
Ndryshime në konfliktin në familje si rrjedhojë e COVID-19




familje janë rritur si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19.

Vetëm 6% e grave u shprehën se janë ndjerë të pasigurta brenda familjes së tyre në gjashtë muajt e fundit. Ndërsa ato që përjetuan konflikte të shpeshta (të paktën çdo javë) mes të rriturve në familje kishin gjashtë herë më shumë gjasa që të ndiheshin të pasigurta në shtëpitë e tyre (20% krahasuar me 3% të grave që u shprehën se rrallë kanë pasur konflikt në familje). Për më tepër, gratë që u shprehën se sigurojnë më shumë të ardhura se partneri i tyre kishin tre herë më shumë gjasa të ndiheshin të pasigurta në shtëpitë e tyre (15%, krahasuar me 5% ndër gratë që fitonin njësoj ose më pak), po ashtu edhe gratë që jetonin me fëmijë në krahasim

me gratë që jetonin pa fëmijë (8% krahasuar me 4%).

Rreth një në gjashtë gra (16%) u shprehën se pandemia e COVID-19 ka përkeqësuar ndjesitë e sigurisë së tyre brenda shtëpisë. Njësoj si me gjetjet për konfliktin në familje, gratë që raportuan të ardhura më të pakta kishin më shumë gjasa të shpreheshin se COVID-19 i ka përkeqësuar gjërat në lidhje me sa të sigurt ndihen në shtëpitë e tyre (18%, krahasuar me 12% të grave që nuk raportuan pakësim të të ardhurave), duke sugjeruar kështu ndikimin e faktorëve stresues ekonomikë në ndjesitë e grave lidhur me sigurinë në shtëpi. Mes grave që ishin ndjerë të pasigurta në shtëpitë e tyre, 58% u shprehën se COVID-19 i kishte përkeqësuar gjërat, duke

FIGURA 3
Perceptimet e sigurisë së grave në familje sipas shpeshtësisë së konfliktit në familje




përforsuar argumentin se pandemia COVID-19 ka thelluar dobësitë ekzistuese dhe problemet e sigurisë për gratë në Shqipëri.

Kur u pyetën pse janë ndjerë të pasigurta në shtëpitë e tyre, gratë përmendën më shpesh

pamundësinë për të komunikuar ose për të kërkuar ndihmë (38%), praninë e dhunës fizike kryesisht në shtëpi (34%), praninë e dhunës fizike ndaj të rriturve të tjerë (38%), ose ndaj fëmijëve (32%).

FIGURA 4

Arsyet përse gratë ndjehen të pasigurta në shtëpitë e tyre (nga 6% e atyre që raportuan se ndiheshin të pasigurta)



3.2 Siguria personale në vende publike


Kur gjenden në hapësirat e jashtme të komuniteteve të tyre, shumica e grave u shprehën se ndihen të sigurta të ecin nëpër zonat ku jetojnë gjatë ditës (87%), por kjo bie në 56% kur u drejtohet e njëjta pyetje rreth ecjes vetëm gjatë natës; pothuajnjë në katër gra (22%) u shpreh se me fillimin e pandemisë së COVID-19, ndihen më pak të sigurta kur gjenden jashtë gjatë natës. Gratë më të reja, të moshës 18-39 vjeç, kishin më shumë gjasa se gratë e grupmoshave më të mëdha, të ndiheshin të pasigurta duke ecur vetëm gjatë natës (42% krahasuar me 28%

të grave të moshës 40 vjeç e sipër), po ashtu edhe gratë beqare (39%).

Gratë që u shprehën se mendojnë që DhNG-ja përbën një problem në komunitetin e tyre, si dhe ato që u shprehën se ato vetë apo një grua tjetër që ato njohin kishte përjetuar DhNG, kishin më pak gjasa të ndiheshin të sigurta duke ecur vetëm, qoftë natën apo ditën se sa të gjitha gratë e intervistuar mesatarisht. Këto grupe kishin gjithashtu më tepër gjasa të shpreheshin se ndjesia e tyre e sigurisë në publik ishte ulur me fillimin e pandemisë së COVID-19.

FIGURA 5

Perceptimet e sigurisë në publik sipas perceptimit të DhNG-së



4. PERCEPTIMET RRETH DHUNËS NDAJ GRAVE

4.1 Siguria e perceptuar nga gratë brenda në shtëpi


Pavarësisht se një pakicë grash raportojnë se janë ndjerë të pasigurta në shtëpitë e tyre, gjysma (51%) e grave u shprehën se përjetimi i abuzimit verbal ose fizik nga partneri ndodh rëndom tek gratë.⁸ Gratë që u identifikuan si beqare kishin më shumë gjasa se sa gratë e intervistuar mesatarisht të mendonin se kjo ishte e zakonshme (59%), po ashtu edhe gratë e punësuar (56%), ato që jetonin në zona urbane (53%), dhe ato me arsim të lartë (58%).

Njësoj si me perceptimet e sigurisë në hapësirat publike, përvoja personale duket të jetë e lidhur me opinionin personal për sa i përket

sigurisë së perceptuar brenda shtëpisë. Mes grave që janë ndjerë të pasigurta në shtëpinë e tyre, 75% u shprehën se mendonin që përjetimi i abuzimit verbal ose fizik nga partneri është i zakonshëm, ndërsa mes grave që kishin konflikte të shpeshta në familje ky numër ishte 68%, duke theksuar gjatat që siguria e grave brenda shtëpisë ndikon në perceptimin e tyre për sigurinë e grave në komunitetin e tyre.

Gratë që e shohin abuzimin nga partneri si të zakonshëm kishin gjithashtu më shumë gjasa të kishin më shumë pasiguri ushqimore sesa ato që nuk e konsideronin të tillë, duke e rithek-suar rëndësinë e sigurisë ekonomike në lidhje me ndjesinë më të gjerë të sigurisë së grave.

⁸ Bashkon përgjigjet “e zakonshme” dhe “shumë e zakonshme”.


FIGURA 6**Perceptimet e abuzimit nga partneri sipas perceptimeve lidhur me sigurinë**

Ndërsa 51% e grave mendojnë se abuzimi nga partneri është i zakonshëm, vetëm 17% pohuan se ato vetë apo gra të tjera që njohin kanë përjetuar dhunë fizike; ndërkohë 29% shprehen se kanë përjetuar abuzim verbal gjatë jetës dhe vetëm 6% pranojnë të jenë ndjerë të pasigurta në shtëpitë e tyre, duke lënë të nënkuptohet se pavarësisht diskutimeve të pareshtura rreth dhunës në familje mes miqsh e familjarësh, kjo dhunë mbetet sërish në nivele të ulëta raportimi pranë autoriteteve ose përmes studimeve.

Shumica e grave të anketuara (79%) mendojnë se situata është përkeqësuar që prej fillimit të pandemisë, përse i takon përjetimit të dhu-

nës fizike apo verbale të ushtruar nga partneri, shifër kjo e cila shkon në 85% të grave që mendojnë se kjo lloj përvojë është më se e zakonshme.

Gratë që raportuan të kishin përjetuar ato vetë DhNG ose gra të tjera që njohin, si gjatë jetës, ashtu edhe që prej fillimit të pandemisë së COVID-19, ishin më të prirura të mendonin se abuzimi nga partneri ishte dukuri më se e zakonshme në komunitetet e tyre (64%, krahasuar me 36% të grave që nuk mendonin kështu). Këto të dhëna tregojnë se gratë bazohen te përvoja e tyre personale kur raportojnë rreth përvojave të grave të tjera në komunitet.

FIGURA 7**Perceptimet e dhunës nga partneri sipas shkallës së ekspozimit apo njohurive rreth DhNG-së**

Shumica e grave (69%) besonin se gratë kërkojnë ndihmë vetëm nëse abuzohen fizikisht ose verbalisht nga partneri. Kjo shifër është fare pak më e ulët se shifra e grave që mendojnë se gratë kërkojnë ndihmë kur ndjehen të pasigurt në publik. Shumica e grave (54%) besojnë se këto gra kërkojnë fillimisht ndihmë nga familja, shifër kjo më e lartë krahasuar me 48% të grave që mendojnë se mbështetja familjare është ndihma e parë që duhet kërkuar në rast ngacmimesh publike.


Ndonëse 38% e grave shprehen se mbështetja ose ndihma ligjore për raportimin e episodeve të dhunës ose referimi në polici ishte burim i disponueshëm në komunitetin e tyre, më pak se 1 në 5 gra (18%) u shprehën se në raste të tilla do t'i drejtoheshin fillimisht policisë, një rënie kjo krahasuar me 35% të grave që mendojnë se ndihma e policisë duhet kërkuar e para në rast ngacmimesh publike. Për më tepër, gratë që u shprehën se janë ndjerë të pasigurt në shtëpitë e tyre ishin shtatëfish më të prirura të kërkonin fillimisht ndihmën e miqve (7% krahasuar me 1% të grave që nuk ndanin këtë mendim). Këto të dhëna tregojnë se dhuna në

familje raportohet në nivele të ulëta të autoritetet krahasuar me format e tjera të DhNG-së.

4.2 Perceptimet mbi dhunën ndaj grave në komunitet

Një e treta e grave në Shqipëri (33%) u shprehën se mendojnë që dhuna, abuzimi dhe ngacmimi i grave në komunitetin e tyre është 'disi problem', dhe 19% prej tyre u shprehën se është 'pak problem'. Gratë e moshës 18-29 vjeç, ato beqare dhe ato që jetonin në zona urbane, kishin më shumë gjasa të mendonin se dhuna, abuzimi dhe ngacmimi i grave është problem në komunitetin e tyre.

Gratë që kanë përjetuar vetë probleme sigurie, qoftë brenda apo jashtë shtëpisë, kishin më tepër gjasa të perceptonin dhunën, abuzimin dhe ngacmimin e grave si një problem në komunitet, duke treguar se kushtet e sigurisë brenda shtëpisë ndikojnë në pikëpamjet mbi mjedisin jashtë shtëpisë.

FIGURA 8**Shkalla në të cilën dhuna, abuzimi apo ngacmimi përbën problem në komunitet**

Pothuajse një e treta e grave (29%) u shprehën se mendonin që dhuna, abuzimi dhe ngacmimi i grave në komunitetin e tyre është rritur që nga fillimi i pandemisë së COVID-19, dhe 52% e të anketuarave u shprehën se nuk ka pësuar ndryshim. Vlen për t'u përmendur se gratë që raportuan se ndiheshin të pasigurta në shtëpitë e tyre kishin më shumë gjasa të perceptonin një rritje të dhunës, abuzimit dhe ngacmimit të grave që nga fillimi i pandemisë së COVID-19 (41%, krahasuar me 28% të grave që ndiheshin të sigurta në shtëpitë e tyre), po ashtu si gratë që kishin përjetuar, ose njihnin dikë që kishte përjetuar një formë të DhNG-së në jetën e tyre (34%, krahasuar me 22% të grave që nuk e kishin përjetuar). Kjo tregon se pandemia COVID-19 mund të ketë përkeqësuar edhe më tej kushtet ekzistuese me rrezikshmëri të lartë për gratë e cenueshme në Shqipëri.

4.3. Perceptimi i grave për sigurinë në vende publike

Perceptimet e grave për sigurinë e tyre personale në vende publike përkonin me perceptimet e tyre se sa e zakonshme ishte që gratë në komunitet të ndiheshin të pasigurta në hapësira publike gjatë natës. Katër nga dhjetë gra (39%) mendojnë se është e zakonshme që gratë të përjetojnë ngacmime dhe probleme sigurie në hapësira publike gjatë natës, në përputhje me 34% të grave që u shprehën se ato vetë ndihen të pasigurta gjatë natës.

Njësoj si me rezultatet për ndjenjat e tyre personale të sigurisë, gratë më të reja të moshës 18-29 vjeç (45%) dhe gratë beqare (47%) kishin më shumë gjasa të shpreheshin se është e zakonshme që gratë të përjetojnë probleme sigurie kur gjenden jashtë gjatë natës krahasuar me gratë në moshë më të madhe apo ato që kishin partner. Gratë që u shprehën se jetonin në zona urbane kishin më tepër gjasa të mendonin se kjo ishte e zakonshme në krahasim me


ato në zonat rurale (42% krahasuar me 32%).

Është interesante që këto shifra nuk përkojnë kur gratë pyeten nëse gjërat janë përmirësuar apo përkeqësuar në drejtim të sigurisë në hapësirat publike gjatë natës që nga fillimi i pandemisë së COVID-19, pasi më shumë se gjysma e grave (57%) u shprehën se situata është përkeqësuar, duke zbuluar kështu një hendek

midis perceptimit të përgjithshëm të sigurisë dhe ndjesisë apo përvojës personale. Në veçanti, gratë e moshës 50 vjeç e sipër, si dhe gratë që kishin një partner, kishin më shumë gjasa të mendonin se gjërat janë përkeqësuar (përkatësisht 65% dhe 61%), ndërsa gratë më të reja, të moshës 18-29 vjeç dhe ato beqare kishin më pak gjasa (përkatësisht 43% dhe 41%).

FIGURA 9

Perceptimet e problematikave të sigurisë sipas ekspozimit dhe njohurive rreth DhNG-së përgjatë jetës



Tre nga katër gra (75%) besonin se gratë që përjetonin ngacmime apo abuzime në vende publike do të kërkonin ndihmë, dhe pothuajse gjysma (48%) besonin që gratë do të kërkonin së pari mbështetje nga familja, ndërsa një e treta (35%) besonin se fillimisht ato do t'i drejtoheshin policisë. Kjo përkonte me 38% të grave që u shprehën se mbështetja ligjore, ndihma në raportimin e incidenteve ose drejtimi pranë policisë ishte një burim i disponueshëm në komunitetin e tyre.

Pavarësisht, çdo ndjenjë ankthi dhe frike që gratë mund të kenë përjetuar jashtë ambi-


entit të familjes nuk duket se i ka ndaluar ato nga angazhimet e tyre në hapësira publike. Katër nga pesë gra (81%) u shprehën se kishin dalë nga shtëpia të paktën një herë në javë, dhe më shumë se gjysma (57%) dilnin çdo ditë, megjithëse kjo shifër anon më shumë nga gratë e punësuar (76%) dhe ato që jetonin në zonat urbane (67%). Shumica e grave u shprehën se vazhdojnë të takohen me miqtë dhe grupet e tyre shoqërore rregullisht (15%) ose më pak (78%), pavarësisht kufizimeve që lidhen me pandeminë e COVID-19.

5. PASOJAT E DHUNËS NDAJ GRAVE

Ky studim nxjerr në pah raportin e ngushtë që ekziston midis masave kundër DhNG-së, ndryshimeve të sjelljes së grave dhe ndjesive të shëndetit të tyre mendor, duke treguar se për-

shtypjet apo përvojat e tyre lidhur me sigurinë (ose mungesën e saj) mund të jenë vendimtare për mirëqenien e grave.

FIGURA 10
Vlerësimet për shëndetin mendor sipas përjetimeve lidhur me sigurinë



Krahas lidhjes ndërmjet problemeve me sigurinë dhe mirëqenien mendore dhe emocionale, sikurse mund të shihet nga figura 10, 37% e kishin vështirë të mos shqetësoheshin, 29% kishin pak interes apo kënaqësi për të bërë gjëra dhe 35% ndiheshin të mërzitura, në depresion ose pa shpresë të paktën gjysmën e kohës që nga fillimi i pandemisë. Megjithatë, këto ndjesi ishin më të theksuara ndër grupe specifike, si për shembull: gratë që jetonin në zona rurale (41% nuk kishin arritur të kontrollonin shqetësimin e tyre, 34% kishin pak interes apo kënaqësi për të bërë gjëra dhe 43% ndiheshin të mërzitura, në depresion ose pa shprese), ato që kishin

nivele më të ulëta arsimimi (44%, 33% dhe 46% përkatësisht), dhe më e larta ndër ato që deklarorin se kishin një aftësi të kufizuar (55%, 39% dhe 48% përkatësisht). Këto grupe kishin gjithashtu më tepër gjasa nga gjithë kamioni i grave të intervistuar të raportonin simptoma të depresionit dhe ankthit të paktën gjysmën e kohës që nga fillimi i pandemisë.


Gratë që kishin përjetuar ndjenja depresioni të paktën gjysmën e kohës ishin dy deri në katër herë më të prirura që të përjetonin pasiguri të mëdha lidhur me ushqimin, krahasuar me ato që raportonin se nuk i kishin përjetuar kurrë këto ndjesi.

Gratë që pohuan të kishin pasur probleme me sigurinë, si brenda shtëpisë ashtu edhe jashtë saj, ishin më të prirura të raportonin simptoma ankthi dhe depresioni të paktën gjysmën e ko-

hës që nga fillimi i pandemisë, duke treguar kështu impaktin negativ që ka pasur pandemia COVID-19.

FIGURA 11

Ndikimet e pandemisë së COVID-19 te shëndeti mendor sipas përjetimeve lidhur me sigurinë



Gratë që raportonin të kishin përjetuar rënie të të ardhurave gjatë vitit të kaluar (53%) dhe që kishin përjetuar ndonjë formë të DhNG-së që prej fillimit të pandemisë së COVID-19 (52%) kishin më tepër gjasa të raportonin një ndikim negativ ekskluziv mbi shëndetin e tyre mendor si rezultat i COVID-19. Ky grup grash kishte gjithashtu më tepër gjasa të kishte pasiguri ushqimore. Kjo tregon se, siç vërehet nga raportet e mëparshme, ndikimet negative të COVID-19 janë ndjerë më tepër nga ato gra që ishin tashmë në vështirësi.

Më shumë se gjysma e grave (56%) thanë se burime të tilla si specialistët profesionistë të shëndetit mendor nuk i ishin vënë në dispozicion komunitetit si shërbim mbështetës në komunitetet e tyre. Gratë që janë ndjerë

të pasigurta në shtëpi ishin më të prirura ta shprehnin këtë gjë (63%), njësoj si gratë që raportuan të kenë pasur debate dhe konflikte në shtëpi (62%), duke kufizuar më tej aftësinë e grave të cënueshme për të marrë ndihmën që u nevojitet. Ndikimi i dhunës ndaj grave në mjedise private dhe publike është vërejtur edhe gjatë analizimit të tipareve të shoqërizimit dhe lëvizjes së grave. Ndonëse shumica e grave (57%) raportuan se kanë dalë përditë nga shtëpia gjatë muajit të fundit, gratë që janë ndjerë të pasigurta në shtëpi kanë pasur më pak mundësi të dalin përditë nga shtëpia vetëm gjatë të njëjtës periudhë (45%) dhe kanë qenë më të prirura të raportojnë se pandemia e COVID-19 ka kufizuar ndërveprimin e tyre me miqtë dhe grupet shoqërore (85% krahasuar me 77%).

6. REKOMANDIME

Ndikimeve të COVID-19 të DhNG-ja në Shqipëri duhet t'u kushtohet vëmendja e duhur pasi një përqindje e konsiderueshme e grave në vend janë ndjerë më pak të pasigurta brenda dhe jashtë shtëpisë, sidomos që prej fillimit të pandemisë së COVID-19. Me rreth 26% të grave që kanë përjetuar pasiguri ushqimore në kohën e studimit dhe me 56% që thonë se kanë pasur rënie të të ardhurave kryesisht për shkak të pandemisë COVID-19, faktorët e jashtëm që mund të rrisin rrezikun e përjetimit të DhNG-së janë në rritje. Kjo duhet shfrytëzuar si mundësi për të identifikuar faktorët që mund të reduktojnë rrezikun e DhNG-së, si dhe për të përdorur metoda më efektive për adresimin e menjëherëshëm të DhNG-së.

Ky studim tregoi se DhNG-ja në Shqipëri është problematikë ndërsektoriale, pasi prek në shkallë të ndryshme gratë e të gjitha moshave, statusit martesor apo të marrëdhënieve në çift, statuse socio-ekonomike dhe nivele të ndryshme arsimore. Për pasojë, ndërhyrjet e politikave dhe ato programatike kërkojnë përshtatje jo vetëm ndaj faktorëve që nxisin përjetimin e dhunës, por edhe ndaj perceptimeve dhe njohurive rreth DhNG-së, ndërgjegjësimit rreth saj dhe besimit tek burimet e disponueshme që i vijnë në ndihmë grave në përballimin e kësaj dhune. Mbështetur në sa më lart, studimi paraqet tre rekomandime:

1. Planifikoni ndërhyrje për DhNG-në të cilat i targetojnë njerëzit atje ku ndodhen dhe shikoni se si programet e DhNG-së mund të integrohen edhe në ndërhyrje të politikave të fushave të tjera, duke përfshirë këtu edhe përmes integritit të plotë të masave kundër DHNG në planet e rekuperimit nga pandemia COVID-19 si një mundësi për të rindërtuar sa më mirë.

Natyra komplekse e DhNG-së, sidomos në vende si Shqipëria ku normat sociale dhe gjinore mund ta mjeçgullojnë të kuptuarit e

përhapjes së fenomenit, kërkon një qasje politikash gjithëpërfshirëse që ta integrojë këtë çështje dhe ndikimet e saj në një sërë fushash të tjera. Ky studim ka hedhur dritë mbi ndikimin e dukshëm të disa faktorëve të jashtëm që sjellin rrezik për DhNG, veçanërisht në lidhje me varësinë ekonomike. Gratë që janë ndjerë të pasigurta brenda dhe jashtë shtëpie, krahasuar me ato që janë ndjerë të sigurt, kanë më tepër gjasa të jenë të papunësuar, të raportojnë ulje të të ardhurave gjatë vitit të kaluar dhe të shprehen se kanë përjetuar pasiguri lidhur me ushqimin. Prandaj, ndërsa ndërhyrjet e politikave dhe programeve fillojnë të trajtojnë ndrikimin që COVID-19 ka pasur në shoqëri, është e rëndësishme të afresohet dhe cenueshmëria ekonomike e grave pasi mund të luajë një rol mjaft domethënës në dobësimin e favorizuesve kryesorë të DhNG-së.

Sikurse është planifikuar në Strategjinë e re Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030, duhen alokuar burime të mjaftueshme (njerëzore, financiare dhe infrastrukturore etj.) për të avancuar qëllimin e reduktimit të të gjithë formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Përpjekjet e përfshira në SKBGJ kanë për qëllim të fuqizojnë gratë, gratë e reja dhe vajzat në shumëllojshmërinë e tyre, që të kenë kontroll të plotë dhe të vendosin lirisht dhe në mënyrë të përgjegjshme mbi çështje që lidhen me shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues.

Qasjet që shkojnë përtej integritit gjinor, për t'i vendosur gratë në qendër të zhvillimit të politikave dhe për të mbështetur integritimin e tyre ekonomik janë të domosdoshme për të ndërtuar plane afatgjata rekuperimi nga pandemia COVID-19, të cilat i shërbejnë grave dhe vajzave, veçanërisht atyre që janë më tepër të ekspozuara dhe të rrezikuara nga dhuna me bazë gjinore. Politikat dhe programet gjithëpërfshirëse të rindërtimit duhet të përf-

shijnë më tepër përpjekje për ri-integrimin ekonomik të grave të mbijetuara të dhunës dhe për fuqizimin ekonomik të të gjitha grave.

Përgjatë këtij procesi megjithatë është e domosdoshme të konsiderohen ndikimet që këto ndërhyrje kanë te stresorët e jashtëm, si për shembull ndryshimin e qëllimshëm ose të paqëllimshëm të roleve apo normave gjinore, që mund të shkaktojnë më tepër dëm nëse nuk merren parasysh. Kjo adresohet më tej në rekomandimin e tretë.

2. Punoni për të zgjeruar përgjigjen dhe ofrimin e shërbimeve thelbësore nga autoritetet dhe organizatat e shoqërisë civile dhe për të përmirësuar nivelin e besimit, në mënyrë që të rritet raportimi i rasteve të dhunës, si edhe vetëbesimi dhe ndjesia e sigurisë të gratë.

Megjithëse shumica e grave në Shqipëri mendojnë se gratë duhet të raportojnë rastet e DhNG që përjetohen në hapësirat publike dhe private, shumica e tyre gjithashtu besojnë se ndihma duhet kërkuar më tepër nga familja, sesa nga kanalet zyrtare. Për më tepër, me përjashtim të shërbimeve mjekësore, shumica e grave në Shqipëri nuk janë në dijeni ose nuk kanë akses në burime mbështetëse nëse e gjejnë veten në një situatë të pasigurt apo vulnerabël, gjë që tregon se ka ende punë për të bërë për të rritur ndërgjegjësimin dhe qasjen në shërbime, veçanërisht atyre që lidhen me mbrojtjen dhe shëndetin mendor.

Kjo mbështet të dhëna të mëparshme që tregojnë se pandemia COVID-19 mund të ketë përkeqësuar kushtet ekzistuese të rrezikshmërisë për gratë në situata të cenueshme. Ndaj, rritja e rolit të policisë në monitorimin e urdhrave të mbrojtjes për ato gra që e kanë raportuar tashmë dhunën është kritike. Përveç mbështetjes ndaj grave që kanë përfituar nga mbështetja e autoriteteve, duhet më tepër punë për të arritur objektivat e SKBGJ-së për të ofruar qasje më të mirë në shërbime dhe drejtësi dhe në shërbime mbështetëse të specializuara për gratë e reja dhe vajzat në gjithë shumëllojshmërinë e tyre. Ky studim zbuloi se

ndërsa disa gra do të raportonin menjëherë në polici rastet e DhNG, përgjigja më e shpeshtë ishte mbështetja të familja. Vetëm rreth një e treta janë në dijeni ose kanë pasur akses në mbështetje ligjore ose ndihmë në raportimin e rasteve në polici. Studime të ndryshme kanë treguar se ky perceptim shpesh lidhet ngushtë me mungesën e besimit të institucionet, që mund të ndërtohet duke forcuar kapacitetet e këtyre institucioneve përmes t'ju përgjigjur rasteve të DhNG, duke garantuar kështu disponueshmërinë e shërbimeve cilësore, etike dhe të fokusuar tek e mbijetuara. Vëmendje parësore i duhet kushtuar ofruesve të shërbimeve që shërbejnë si pika e parë e kontaktit për gratë për të garantuar sigurinë e të mbijetuarave, si edhe përpjekje për të vënë në pah rolin e policisë në raportimin e DhNG.

Më tepër se gjysma e grave (56%) thanë se specialistët e shëndetit mendor nuk janë të disponueshëm si shërbime mbështetëse për gratë në komunitetin e tyre, megjithatë shumë gra raportojnë se vuajnë nga simptoma të ankthit dhe depresionit si para ashtu edhe si rezultat i pandemisë. Kjo tregon se ka nevojë për më tepër shërbime të aksesueshme të shëndetit mendor, duke i vendosur këto shërbime për shembull në qendra shëndetësore parësore dhe në komunitet në mënyrë që sa më tepër gra të kenë akses.

3. Mbështesni studime të mëtejshme që shkojnë përtej të kuptuarit të përhapjes së DhNG-së për të analizuar normat sociale dhe sjelljet që fshihen pas kësaj dhune, sidomos sjelljet që thyejnë tabutë dhe synojnë kërkimin e ndihmës.

Ndonëse ky studim jep informacione mjaft të vlefshme për situatën aktuale të DhNG-së në Shqipëri, ka shumë rëndësi të kryejmë studime të tjera për të kuptuar nuancat që nuk mund të dallohen lehtësisht, për shkak të barrierave metodologjike dhe kontekstuale. Nëse masat e distancimit social dhe izolimit në shtëpi vijnë të pengojnë mbledhjen e të dhënave ballë për ballë, duhen gjetur metoda të reja të shtëpi,

qoftë anketimit në distancë për të lehtësuar respektimin e standardeve metodologjike, etike dhe të sigurisë të dakordësuara në rang global.

Studimet cilësore në veçanti do të ishin shumë të dobishme për të kuptuar më mirë se si ta largojmë stigmën e DhNG-së duke ndërtuar një kornizë më të detajuar të normave gjinore dhe shoqërore dhe arsyeve se përse gratë kërkojnë (ose nuk kërkojnë) ndihmë në kanale zyrtare. Vrojtimi me Bazë Popullatëng i 2018-ës zbuloi se në Shqipëri mbizotërojnë normat shoqërore që nxisin druajtjen dhe heshtjen rreth dhunës në familje dhe dhunës seksuale. Më shumë se gjysma (52%) e grave dhe vajzave të intervistuarua të grupmoshës 18-74 vjeç u shprehën se të gjithë ose shumica e anëtarëve të komunitetit të tyre besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe thujse gjysma e grave (47%) u shprehën se të gjithë ose shumica e anëtarëve të komunitetit besojnë se një grua duhet ta tolerojë dhunën për të mbajtur familjen e bashkuar. Edhe qëndrimet fajësuese rreth dhunës në familje dhe dhunës seksuale janë mjaft të përhapura, ku rreth një e treta e grave mendojnë se të gjithë ose shumica e anëtarëve të komunitetit besojnë se kur një grua rrihet nga burri ajo është pjesërisht ose tërësisht fajtore (28%) dhe mbi një e pesta e grave (21%) shprehen se të gjithë ose shumica e anëtarëve të komunitetit besojnë se nëse një grua përdhunohet ka bërë me shumë mundësi ndonjë paturpësi që e ka çuar veten deri në atë pikë.

Investimi në studime të mëtejshme është i rëndësishëm për të kuptuar më mirë normat shoqërore dhe sjelljet favozruese të dhunës, e për pasojë edhe mënyrat më të mira për t'i luftuar dhe ndryshuar qëndrimet rreth DhNG-

së dhe për t'i ndihmuar gratë viktime të kësaj dhune që të ndihen më të sigurta dhe të lirshme kur kërkojnë ndihmë nëpërmjet kanaleve zyrtare. Për shembull, ky studim tregon se gratë më të reja janë më tepër të prirura të raportojnë eksperiencat personale apo kur kanë dijeni për raste të DhNG, që tregon se më tepër duhet bërë për të mbështetur këto gra në veçanti. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e iniciativave për rritjen e ndërgjegjësimit për të ndryshuar normat shoqërore ose gjinore dhe sjelljet që mundësojnë ciklin e vazhdueshëm të DhNG ndërmjet të rinjve. Gjithashtu, është e rëndësishme të punohet më tepër me të rinjtë për të adresuar ngacmimin seksual, abuzimin verbal, dhunën intime ndërmjet adoleshentëve dhe dhunën digjitale/kibernetike.

Përveç këtyre iniciativave specifike, është e rëndësishme të shfrytëzojmë programe ekzistuese që punojnë me gratë në komunitet për të ofruar edukim dhe mbështetje të mëtejshme në lidhje me DhNG, duke përfshirë këtu rritjen e ndërgjegjësimit rreth burimeve të disponueshme për gratë në situata të cenueshme. Shërbimet e qendëruara mund të mos jenë të aksesueshme për të gjitha gratë që përjetojnë dhunë nga partneri ose një anëtar tjetër i familjes, jo vetëm sepse dhuna në familje shpesh konsiderohet çështje private por edhe prej mungesës së qasjes në këto shërbime dhe prej frikës së hakmarrjes. Më tej, socializimi dhe lidhjet me të tjerë jashtë shtëpisë mund të ofrojnë sisteme të rëndësishme mbështetje dhe një mënyrë shpëtimi për gratë që ndjehen të pasigurta në shtëpi. Programet që i lejojnë këto gra të lidhen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt me njerëz jashtë shtëpisë së tyre, virtualisht ose ballë për ballë, mund të jenë një mjet i fuqishëm për t'i ofruar këtyre grave mbështetje dhe siguri më të madhe.

9 INSTAT Albania, UNDP dhe UN Women. 2019. [Vrojtim kombëtar me bazë popullatëng : VDhuna ndaj grave e vajzave në Shqipëri.](#)

7. METODOLOGJIA

Anketimi u realizua në periudhën 18 gusht - 20 shtator 2021 nëpërmjet intervistimit telefonik të rastësishëm përmes kompjuterit (CATI). Numri i intervistave të kryera ishte 1,210 gjithsej. Gjatë periudhës së anketimit, Shqipëria po përballej me rritjen e rasteve të reja të COVID-19, ndonëse kjo rritje rastesh filloi të luhatej nga fundi i studimit.¹⁰ Nga mesi i studimit u vendos ora policore gjatë natës, e cila hyri në fuqi më 1 shtator 2021.¹¹ Shqipëria ka pësuar rritje graduale dhe të qëndrueshme të numrit të vaksinimeve gjatë kësaj periudhe.¹²

Kampioni u përzgjedh përmes telefonatave me numra rastësorë, marrë nga numërori i telefonisë celulare të popullsisë, ndaj popullata e kampionit është e kufizuar te gratë mbi 18 vjeç ose te gratë që kanë akses në telefon celular. Gratë mbi 60 vjeç u targetuan në mënyrë të veçantë nëpërmjet bazës ekzistuese të të dhënave për të siguruar mbulimin e duhur të kësaj grup moshe. Megjithatë, përqindjet e çdo grup moshe në këtë anketim përkojnë me përqindjet e çdo grupmoshe në të dhënat e Censurit të Shqipërisë.¹³

Grupmosha	Përqindje e grave të rritura sipas të dhënave të Censurit	Përqindja e të grave të rritura nga të dhënat e kampionit
18–29	24%	23.8%
30–39	16%	16.2%
40–49	15%	14.7%
50–59	17%	17.3%
60+	28%	28%

10 Reuters COVID-19 Tracker. 2021. "Albania" <https://graphics.reuters.com/world-coronavirus-tracker-and-maps/countries-and-territories/albania/>. Accessed in October 2021.

11 US Embassy in Albania. 2021. "COVID-19 Information" https://al.usembassy.gov/updates_covid19/. Accessed in October 2021.

12 Reuters COVID-19 Tracker. 2021. "Albania" <https://graphics.reuters.com/world-coronavirus-tracker-and-maps/countries-and-territories/albania/>. Accessed in October 2021.

13 INSTAT. 2021. "Population by Age group, Sex, Type and Year". http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START_DE/POP01/table/tableViewLayout2/?rxid=63431e2b-dcoc-4f7e-908e-46f973c156d3

PËRKUFIZIME

Komunitet: term që i referohet hapësirës gjeografike ku jeton i/e anketuari/a.

Pasiguri ushqimore: studimi mbështetet në formulën e FAO-s për të matur pasigurinë ushqimore që përbëhet nga një shkallë me tetë nivele. Këto të dhëna mund të përdoren për të llogaritur me përafërsi përqindjen e kampionit që është ndjerë disi ose mjaft e pasigurt lidhur me ushqimin, të cilat mund të kategorizohen edhe në ndryshore të tjera me interes, duke përdorur modulën e FAO-s “Shkalla e Përjetimit të Pasigurisë Ushqimore (FIES)”. Çdo referencë ndaj shpeshësisë mesatare ose të lartë të pasigurisë lidhur me ushqimin nuk është gjë tjetër veçse llogaritje e përafërt dhe duhet interpretuar gjithnjë si e tillë.

Në çift: term që i referohet grave që janë të martuara dhe/ose jetojnë/bashkëjetojnë me një partner.

Dhuna ndaj grave: nënkupton çdo akt dhune me bazë gjinore që shkakton ose mund të shkaktojë lëndim fizik, seksual apo psikologjik, ose vuajtje apo dëmtim të grave, përfshirë kërcënime, kanosje ose mohim arbitrar të lirisë, qoftë në publik apo në shtëpi, qoftëjet në shtëpi, qoftë private.

U ndje e pasigurt për të ecur vetëm: i referohet grave që tregojnë se janë ndjerë “jo shumë të sigurta” ose “aspak të sigurta” për të ecur vetëm gjatë ditës (pyetja Co2) ose gjatë natës (pyetja Co3).

Ka përjetuar ose njeh dikë që ka përjetuar DhNG: I referohet grave që kanë treguar se ato ose një grua që njohin, ka përjetuar ndonjë nga format e DhNG. “Që nga COVID-19” është shtuar për të treguar gratë që kanë thënë se këto ngjarje kanë ndodhur vetëm prej fillimit të pandemisë.

Ka përjetuar konflikt të vazhdueshëm: I referohet të anketuarave që kanë treguar se kanë përjetuar konflikt ose zënka në shtëpitë e tyre të paktën një herë në javë gjatë gjashtë muajve të fundit (pyetja C19).

Ka përjetuar konflikt jo të vazhdueshëm: I referohet të anketuarave që kanë treguar se kanë përjetuar konflikt ose zënka në shtëpitë e tyre “një ose dy herë” ose “asnjëherë” gjatë gjashtë muajve të fundit (pyetja C19).

Dhuna, abuzimi ose ngacmimi i grave është problem në komunitet: I referohet të anketuarave që kanë treguar se dëmi fizik, abuzimi apo ngacmimi i grave është “shumë”, “disi” ose “pak” problem aty ku ato jetojnë (pyetja Co7).

Dhuna, abuzimi ose ngacmimi i grave nuk është problem në komunitet: I referohet të anketuarave që kanë treguar se dëmi fizik, abuzimi apo ngacmimi i grave “nuk është aspak” problem në aty ku jetojnë (pyetja Co7).

© 2021 UN Women. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara apo organizatave në varësi të tyre.

Prodhuar nga Programi “Women Count”

Përkthimi në shqip: Language Solutions
Redaktimi në shqip: Megi Llubani, Estela Bulku
Dizajn: Ouissal Hmazzou



220 East 42nd Street
New York, New York 10017, USA

data.unwomen.org
www.unwomen.org
www.facebook.com/unwomen
www.twitter.com/un_women
www.youtube.com/unwomen
www.flickr.com/unwomen
instagram.com/unwomen